



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	08.05.2025
REFERENC-Ë:	24/6582/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Egi Group", Sh.p.k., Zahaq, Pejë Fabrikë për prodhimin e artikujve të plastikës për paketim, Llabjan dhe Ramun, Komuna Pejës.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore të operatorit, "Egi Group", Sh.p.k., Zahaq, Pejë, me nr. prot. 24/6582/MMPHI, me veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e artikujve të plastikës për paketim, Llabjan dhe Ramun, Komuna Pejës.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/6582/MMPHI
Datë: 08.05.2025.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi, 1, 2 dhe 4 të nenit 12, neni 17, dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori "Egi Group" Sh.p.k. Zahaq, Pejë, me Nr.Prot.24/6582/MMPHI, pajiset **me Leje Mjedisore** për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e artikujve të plastikës për paketim, në ngastrën Nr.P-71611051-00284-5, Zona Kadastrale Llabjan dhe ngastrën Nr.P-71611077-00179-5, Zona Kadastrale Ramun, Komuna e Pejës.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Lënda e para të mbahen në vend të betonuar, izoluar dhe mbuluar;
 - 2.3. Kontejnerët e plastikës në të cilën gjinden zbutësit të mbahen në vende të betonuar dhe izoluar;
 - 2.4. Të mirëmbahen pajisjet kundër zjarrit;

Faqe 2 nga 4

- 2.5. Për sistemin menaxhues të mjedisit të ketë personin përgjegjës të profilit mjedisor;
- 2.6. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Egi Group" Sh.p.k. Zahaq, Pejë, me Nr.Prot.24/6582/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e artikujve të plastikës për paketim, në ngastrën Nr.P-71611051-00284-5, Zona Kadastrale Llabjan dhe ngastrën Nr. P-71611077-00179-5, Zona Kadastrale Ramun, Komuna e Pejës, MMPHI konstaton se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
 - Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
 - Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
 - Pëlqim Mjedisor me nr.24/1958/1-ZSP/ /24, të lëshuar me datë: 13.08.2024;
- Kontratë bashkëpunimi për shitbletrje e lidhur me datë: 03.01.2025, mes Kompanisë "Egi Group" Sh.p.k. Pejë dhe Kompanisë "Italy Recycling" L.L.C. Obiliq

Andaj bazuar në të cekurat më lartë dhe gjendjes faktike në teren, si dhe plotësimit të kushteve të parapara me legjislacionin mjedisor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Faqe 3 nga 4

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Graçanicë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së